



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr.79, Datë 31.05.2019

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE NR. 67
DATË 27.07.2011 PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOSKU - ENERGY” SH.P.K NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4 gërma a, dhe 113 të Ligjit 44/2015 “Kodi i procedurës Administrative”, si dhe 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi “ Një ndryshim në vendimin e bordit të komisionerëve të ERE nr. 67 datë 27.07.2011 për licencimin e shoqërisë “Dosku - Energy” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Konstatoi se:

Bordi i ERE me vendimin nr. 67, datë 27.07.2011, ka vendosur si më poshtë:

1. *Licencimin e shoqërisë “Dosku - Energy” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Gizavesh”, me kusht që: Subjekti “Dosku Energji” sh.p.k të paraqesë Çertifikatën e rregjstrimit të pronësisë branda 2 (dy) vjetesh nga data e dhënies së licencës.*
2. *Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.*
 - ✓ ERE ka evidentuar kushtin e vendimit të licencimit nr. 67, datë 27.07.2011 dhe ka kërkuar nga ana e shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k, me shkresën nr. 691 Prot., datë 01.12.2015, e duke vijuar me shkresën nr. 61 Prot., datë 13.01.2016 informacion mbi statusin e plotësimit të këtij kushti.
 - ✓ Shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 61/1, datë 09.02.2016, ka bërë me dije statusin e plotësimit të kushtit duke sqaruar se Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka kthyer akoma pronën e njohur me vendim gjykate të formës së prerë me arsyetimin se ka një vakum ligjor në funksionimin e këtij komisioni.
 - ✓ Në vijim të problematikës për saktësimet përkatëse mes shoqërive “Dardania” sh.p.k dhe “Dosku Energy” sh.p.k Ministria e Infratrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 5051/1 Prot., datë 11.08.2017, ka komunikuar në ERE ngritjen e një Grupi Pune për

shkak të rëndësisë së problematikave të evidentuara rishtazi në procedurën e ndërtimit me koncesion të formës BOO (ndërtim, shfrytëzim, pronësi), të HEC –it Gizavesh. Në këtë korrespondencë MIE thekson se, nëpërmjet Grupit të Punës do të shqyrtojë gjithë dokumentacionin e kësaj procedure dhe në përfundim të shqyrtimit do të bëjë me dije ERE-n lidhur me vendimin e saj.

- ✓ Në vijim të sa më sipër, ERE ka pezulluar veprimet lidhur me këtë çështje duke qëndruar në pritje të një konkluzioni të grupit të punës së MIE.

Shoqëria “Dosku - Energy” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr.203, datë 05.03.2019 dhe nr. 203/3, datë 03.04.2019, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë duke kërkuar një vendimmarrje nga ERE :

- Çertifikatën e rregjstrimit të pronësisë datë 30.07.2018, lëshuar nga Zyra e Rregjstrimit të Pasurisë së Paluajtshme për zonën kadastrale nr. 1715, Nr. pasurie 527 –N Gizavesh – Librazhd, të shoqëruara me kartelen e pasurisë dhe planvendosjen përkatëse, e cila perkon me zonen ku shtrihet projekti i HEC-it.

Sa më sipër, rezulton se shoqëria “Dosku - Energy” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin e Bordit të ERE nr. 67, datë 27.07.2011.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 67, datë 27.07.2011 si më poshtë:
Licencimin e shoqërisë “Dosku - Energy” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Gizavesh”, me kapacitet të instaluar 0.5 MW.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI